Npi – 01/225 datë: 07.07.2022

PYETJE – PËRGJIGJE

NGA MBLEDHJA E -VII- KUVENDIT MË 07.07.2022

znj.Albana Podvorica: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DSHP-në, sa po ndërrmerrni masa për me e rregulluar çështjen e ujit të pijes dhe energjisë elektrike. sepse kohëve të fundit po kemi shumë problem?
   Përgjigje: DSHP – z.Bardhyl Rushiti, Përgjigje: Sa i perket qështjes së ujit, duhet ta kuptojmë se kjo gjendje nuk është që tani, qe 20 vite nuk është bër diqka me shumë, që sot mos ti kemi këto probleme, edhe duhet ta kuptojmë që jemi në stinën e verës ku temperaturat jane te larta. Dhe të jem I sinqert për 4 muaj ditë që jam në pozitën e drejtorit nuk mundem ta ndryshoj at që nuk është ndryshuar per 20 vite. Ndërsa te qështja e rrymës kemi qenë të informuar aq s akeni qen edhe ju, pershkak që janë duke punuar ne rrjet.

znj.Adelina Beqaj: Kam këto pyetje:

1. Pyetje për DSHP-në, qka po ndodhë te parku i pishave, që janë grumbulluar mbeturinat e nuk po mirëmbahet aty, çka po ndërrmerr drejtoria?
   Përgjigje: DSHP – z.Bardhyl Rushiti, Jemi në dijeni, dhe do të jemi ne kordinim me Kompaninë e pastertisë.

z.Reshat Mujota: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DSHP-në, te menaxhimi i mbeturinave, çka po ndërrmerr Inspektorati, sa është aktiv në teren, sepse unë kam pa që nuk ka rrugë që nuk ka mbeturina. Te rruga e arave në Shtime, që përpara i kanë thane te bunari miles është bërë një deponi, pastaj te rruga "Islam Neziraj" ne Mollopolc po ashtu është bërë një deponi, ku është vërejtë se aty po hudhen mbeturina edhe nga Shtimja por edhe nga Jezerci, unë po kërkoj që këto deponi sa më shpejt të eleminohen dhe të ndërrmerret diçka?
   Përgjigje: DSHP – z.Bardhyl Rushiti, Së shpejti do ta bëjmë një plan për largimin e mbeturinave. Por jemi duke hulumtuar që ta gjejmë një vend të përshtatshëm ku të hudhen mbeturinat Inerte.

z.Muhamet Ademaj: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKGJ-në, sa është numri i objekteve të ndërtuara pa leje në pronat komunale, në qeveritë e kaluara?
   Përgjigje:

znj.Shkurte Mustafa: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKGJ-në, kurë do të përfundojnë punimet te shtatorja e "Adem Jashari"?
   Përgjigje:

2. Pyetja e dytë për DPUKGJ-në, është se ka filluar asfalltimi i rrugës në lagjën Hysenaj, kur do të përfundojë ky projekt?
   Përgjigje:

z.Rexhep Gashi: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKGJ-në, sa leje ndërtimi i ka lëshuar Komuna për persona fizik dhe sa për operatorë ekonomik?
   Përgjigje:

z.Besnik Seferi: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKGJ-në, qka është duke u ndërrmarrë për rregullimin e rrugës "Tranzit" kur dihet mire se në atë rrugë jetojnë një numër i madh i banorëve të komunës tonë?
   Përgjigje:

2. Pyetje për DSHP-në, sa i përket ndriçimit kemi disa rrugë që mungon ndiqimi sikurse në rrugën "Ahmet Shtimja" rrugën në Qestën e Reçakut, në Lagjën e Pajtimit, në Godanc e në shumë fshatra a do të ndërrmirret diçka nga DSHP-ja që të ketë ndriçim?
   Përgjigje: DSHP – z.Bardhyl Rushiti, Pershkak te borgjeve që i kemi trashiguar nga ish pushteti i kaluar po kemi ngecje. Por si do që t jet jemi duke u munduarë të bëjmë zgjidhje te kontratave të trashiguara.

3. Ne në Komitetin për Komunitete, kemi vizituar familjet e Komunitetit Rom dhe Ashkali në komunën tone dhe kemi hasur në një familje që nuk kishte pasë energji elektrike qe disa muaj mua më ka shqetësuar ky fakt se si në këtë shekull një familje mos me pas energji elektrike qe disa muaj, prandaj cila është mundësia që DSHP-ë të ndërrmarrë diqka në bashkëpunim me KEDS-in, cili është bashkpunimi me qëllim që të bëhet një zgjidhje?
   Përgjigje: DSHP – z.Bardhyl Rushiti, Duhet ta kuptojmë Që Kedsi është kompani private dhe ne nuk kemi kompetenca, por jemi te informuar per raste të tilla, dhe kemi bër kerkesa te vazhdueshme ne KEDS por i kanë arsyet e vet apse nuk munden me kry pune. Kemi bere kerkese edhe tek ujësjellësi qe tja mundësojnë kycjen ne trafe te tyre, por që nuk kanë pranuar një gjë të tillë.

4. Pyetje për DSHP-në, Komuna jonë i ka disa parqe, që janë të realizuara mirëpo mirëmbajtja e tyre është në nivel jo të duhur, cilët janë hapat konkrtet që këto parqe të jenë më të mirëmbajtura?
   Përgjigje: DSHP – z.Bardhyl Rushiti, Për shkak të kontratës së mirmbajtjes që është shfrytëzuar po thuajse e tëra nga ish pushteti për 2 muaj fushatë dhe jemi ne kontest, ndersa ana ligjore nuk na lejon që ta bëjmë një kontratë tjetër me specifika të njejta.

5. Sa i përket qështjes së mbeturinave, i përmendi zotri Mujota, mirëpo unë po pyes DSHP-në se sa ka qenë shqiptimi i gjobave për hudhjen e mbeturinave?
   Përgjigje: DSHP – z.Bardhyl Rushiti, janë në proçes.

z.Adem Ramadani: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKGJ-në, pse nuk po asfaltohet rruga "15 Janarai"?
   Përgjigje:

2. Pyetje për DSHP-në, (pyetja nuk mund te kuptohet as nga Stenogrami)
   Përgjigje:

z.Hamëz Tërshani; Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për Kryetarin, a mund të na tregoni për aktivitetet e prokurimit me titull "Shërbimet e interpretimit dhe përfaqësimit të jashtëm ligjor në Komunën e Shtimes" vlera e parashikuar 8600€ (në vazhdim lexoi një tekst lidhur me Avokatë) shqetësimi është ky, qka synoni me këtë,

a nuk keni zyrtar të mjaftueshëm kompetent në komunën e Shtimes apo ka shumë lëndë, që duhet të angazhohet një avokat shtesë. Edhe thjeshtë prej kujt duhet ta mbroni?
Përgjigje:

z.Grejtalb Emini, Drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje, sa i përket pyetjes së Ademit, te rruga "15 Janari" ka disa prej banorëve që po hezitojnë dhe po pyesin për kyqje në Kanalizim, për shkak që po duhet me pas prerje të asfalltit për këtrë arsye deri tash e kemi shty asfalltimin e rrugës 15 Janari" Sa i përket pyetjes së Shkurtes për projektin e shtatores së "Adem Jashari" besoj se pas festës së Kurban Bajramit do të përfundoi komplet ky projekt. Pyetjet tjera normalisht i merrni me shkrim.

z.Adem Ramadani: Pse ju si Komunë nuk po ju ndihmoni banorëve për me u kyqë aty me 3-4 metra çdo familje aty me një lidhje direct për mos me pas pastaj prerje të asfalltit?
Përgjigje:

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E SHTIMES-OPSTINA ŠTIMLJE
SHTIME-ŠTIMLJE

v.v.

Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi